



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

<b>DATË/A:</b>	10.03.2025
<b>REFERENC-Ë:</b>	24/5629/MMPHI
<b>PËR/ZA/TO:</b>	"Runfill" Sh.p.k Arbanë-Barikadat, p.n. Prizren, Fabrika e prodhimit të produkteve për pastrim-detajim, shamponëve dhe aromave për makina në Z.K. Dushanovë, Komuna e Prizrenit.
	Komisioni për Leje Mjedisore.
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	Arkivës së MMPHI-së
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI.
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim për ndërprerje procedurës së Lejes Mjedisore.

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për pajisje për Leje Mjedisore të operatorit "Runfill" Sh.p.k., Prizren, për veprimtarinë: Fabrika e prodhimit të produkteve për pastrim-detajim, shamponëve dhe aromave për makina në zona kadastrale Dushanovë, Komuna e Prizrenit.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe një sërë takimesh, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Nr.: 24/5629/MMPHI

Datë: 10.03.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr.13/2024 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 3 të nenit 10, të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

1. Operatorit "Runfill" Sh.p.k., Prizren i ndërpritet procedura administrative për veprimtarinë: Fabrika e prodhimit të produkteve për pastrim-detajim, shamponëve dhe aromave për makina në ngastrën nr. 00314-9, zona kadastrale Dushanovë, Prizren.

## A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin "Runfill" Sh.p.k., Prizren me nr. pot. 24/5629/MMPHI, për veprimtarinë: Fabrika e prodhimit të produkteve për pastrim-detajim, shamponëve dhe aromave për makina, në ngastrën nr. 00314-9, zona

kadastrale Dushanovë, Prizren, konstatohet që operatori **nuk i plotëson** kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për vazhdimin e Lejes Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrit të biznesit-ARBK;
- Pëlqimin Mjedisor, Nr.24/2446/1-ZSP/ të lëshuar me datë: 05.07.2024;

MMPHI, ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve si në vijim:


- Leje ujore për shfrytëzim dhe
- Leje ujore për shkarkim.

Operatori nuk ka sjell dëshmi për plotësimin e dokumentacionit të cekur me lartë.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **ndërpret procedurën administrative** në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.





Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Prizren;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së